



**VENDIM**

**Nr. 16 Datë 17.02.2012**

**MBI  
KAPACITETET E INTERKONJEKSIONEVE NE DREJTIMIN IMPORT  
EKSPORT PER MUAJIN MARS 2012**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma ç, paragrafi ii, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, ”, pikës 7, gërma b, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe Kapitullit X, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.02.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Cez Shpërndarje sh.a dhe Kesh sh.a me nr. 807, Prot, dhe nr. 642 Prot date 10.02.2012, ne lidhje me alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve ne drejtimin import për një periudhë 3-4 mujore, u njoh me opinionin e OST sh.a mbi këtë kërkesë, dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut

**Konstaton:**

- Mungesën e theksuar te reshjeve gjate gjithë vitit 2011 dhe për periudhën në vijim e cila reflekton një situatë të vështirë hidroenergjetike , me nivele shumë të ulëta te rezervës hidrike ne kaskadën e lumit Drin si dhe basenet e tjera te HEC-eve qe operojnë ne vendin tone. Me date 14.02.2012 kuota ne basenin e HEC Fierzë rezulton 259 metra
- Moti me temperatura te ulëta është shoqëruar me një rritje te ndjeshme te kërkesës për energji elektrike dhe si te tille e nevojës për te importuar energji elektrike ne pamundësi te plotësimit te kërkesës për energji te klientëve tarifore

nga prodhimi vendas. Nga administrimi i te dhënave të marra në evidencën e dërguar nga OST rezultoi se konsumi për energji elektrike ka shënuar vlerën rreth 25 milion KWh dhe si të tilla është rritur kërkesa për mbulimin e këtij konsumi nëpërmjet importit të energjisë elektrike nga vendet fqinje i cili aktualisht rezultoi në vlerën rreth 10 milion KWh.

- Rritja e kërkesës për energji elektrike dhe si të tilla e sasisë së energjisë elektrike për të importuar nga dy kompanitë bënë që KESH sh.a. dhe Cez Shpërndarje të kenë nevojë për kapacitete të sigurta dhe të plota të kapaciteteve të interkonjeksionit në të gjitha linjat përkatëse të Shqipërisë me vendet fqinje për të siguruar furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve në vend.
- Me datë 12.02.2012, Këshilli i Ministrave vendosi shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore, si pasojë e përkeqësimit të kushteve natyrore të motit, në njësitë e qeverisjes vendore të qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe rrethin e Librazhdit.

Për gjithë sa më sipër me qëllim mos cenimin e furnizimit pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve të energjisë elektrike (tarifore dhe të kualifikuar) Bordi i Komisionerëve

#### **Vendosi:**

1. Për muajin Mars 2012, OST do të alokojë proporcionalisht kapacitetet e interkonjeksionit në drejtimin import – eksport, për mbulimin e kërkesës për energji elektrike nga Klientët Tarifore përfshirë humbjet në sistemin e shpërndarjes, në masën 365 MW, dhe për mbulimin e kërkesës për energji elektrike nga Klientët e Kualifikuar në masën 40 MW, në përputhje me nominimet fizike të paraqitura në OST nga pjesëmarrësit e tregut sipas Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.